



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DY ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ NR. 79, ANËTARIT TË KZAZ-SË NR 89, ANËTARIT TË EMËRUAR KRYESISHT TË KZAZ NR. 03 DHE SEKRETARIT TË EMËRUAR KRYESISHT TË KZAZ NR.15 PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për lirimin dhe emërimin e dy anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ nr. 79, anëtarit të KZAZ-së nr.89, anëtarit të emëruar kryesisht të KZAZ nr. 3 dhe sekretarit të emëruar kryesisht të KZAZ nr.15 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

**V Ë R E N**

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- me shkresën nr. 11095, datë 07.06.2019:
  - lirim të anëtarit të KZAZ nr. 89, Bashkia Finiq, z. Kristaq Thanasi dhe emërim të z. Thoma Lango;
- me shkresën nr. 11119, datë 08.06.2019:
  - lirim të anëtarëve të KZAZ nr. 79, Bashkia Libohovë, zj. Majlinda Gjika, z. Rahim Skenderi, sekkretarit z. Julian Rustemi dhe emërim në vend të tyre të zj. Arjana Çano, z. Rigels Ismailati, z. Sami Shameti;

---

**Nr. 829 i Vendimit    Data 10.06.2019 e Vendimit    Ora 14:00 e Vendimit**



Për lirimin dhe emërimin e dy anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ nr. 79, anëtarit të KZAZ-së nr.89, anëtarit të emëruar kryesisht të KZAZ nr. 3 dhe sekretarit të emëruar kryesisht të KZAZ nr.15 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Me shkresën nr.10016 prot., datë 06.06.2019, anëtari i KZAZ-së nr.3 z.Emiljan Karma, i emëruar kryesisht me vendimin Nr. 141, datë 09.04.2019 të KQZ, për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.

Me shkresën nr.11120 prot., datë 08.06.2019, sekretari i emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin Nr. 794, datë 03.06.2019 për plotësim të vakancës në KZAZ-së nr. 15, z. Gersi Sula, për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.

KQZ, në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV" për plotësimin e vakancës së pozicionit të anëtarit të KZAZ-së nr.3, Bashkia Shkodër përzgjodhi përmes procedurës së shortit njërin prej 14 shtetasve në listën e miratuar me vendim nr. 140, datë 09.04.2019.

Në listën e shtetasve të miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 09.04.2019, për zonën zgjedhore Bashkia Kurbin, zj.Naile Myftar Hysa, me arsim juridik, është e vetmja shtetase e cila plotëson kriterin për tu emëruar në pozicionin e sekretarit kryesisht në KZAZ-në nr. 15.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

### **V E N D O S I:**

1. Të lirojë nga detyra anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr.79, anëtarin e KZAZ-së nr.89 anëtarin e emëruar kryesisht të KZAZ-së nr. 3 dhe sekretarin e emëruar kryesisht të KZAZ-së nr.15, sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 79, anëtarin e KZAZ-së nr.89, të emërojë kryesisht anëtarin e KZAZ-së nr. 3, dhe sekretarin e KZAZ-së nr.15, sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

**Nr. 829 i Vendimit    Data 10.06.2019 e Vendimit    Ora 14:00 e Vendimit**



Për lirimin dhe emërimin e dy anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ nr. 79, anëtarit të KZAZ-së nr.89, anëtarit të emëruar kryesisht të KZAZ nr. 3 dhe sekretarit të emëruar kryesisht të KZAZ nr.15 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019